

MARREVESHJE

Mbi

ZHVILLIMIN E KLERINGUT

ndërmjet

BANKES SE SHQIPERISE

dhe

BANKAVE TE NIVELIT TE DYTE

Qëllimi

- Sigurimi i një shërbimi Kleringu të përshtatshëm në kohë dhe procedurë, ndërmjet të gjitha Bankave anëtare të tij, për të realizuar pagesat ndërmjet Bankave (ne favor të klientëve), në një kohë sa më të shkurtër,
- Kryerja e Kleringut të pagesave mbi një bazë ligjore, rregullatore, dhe të organizuar, për tërë sistemin bankar shqiptar si dhe,
- Qëllimi final "një shërbim sa më i shpejtë dhe efikas ndaj klientit".

Mbështetur ne

- Ligjin nr.8076 datë 22/02/1996 "Për Bankën e Shqipërisë"
- Ligjin nr. 8075 datë 22/02/1996 "Për sistemin Bankar në Republikën e Shqipërisë "
- Ligjin "Për çekun", nr. 3702, datë 8.7.1993, dhe Ligji nr. 7782, datë 26.1.1994 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Dekretin nr. 3702, datë 8.7.1993 të ligjit për çekun .
- si dhe në të gjitha vendimet dhe aktet e tjera nënligjore të nxjerra për këtë qëllim nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë dhe Komiteti Kombëtar i Pagesave;

Me iniciativën e Bankës së Shqipërisë dhe miratimin e Komitetit Kombëtar të Pagesave, sot më datë / /1998, nënshkruhet kjo "Marrëveshje" ndërmjet Bankave të nivelit të dytë dhe Bankës së Shqipërisë, me këtë përmbajtje

Objekti :

Kryerja e seancave të kleringut, nëpërmjet shkëmbimit fizik të dokumenteve, një mënyrë sa më efektive dhe në një kohë sa më të shkurtër.

PERCAKTIME

- Transaksionet, te cilat do të procedohen në seancat e Kleringut, duhet të jenë të shprehura në Lekë.
- Instrumentet e pagesave, te cilat do të shkëmbehen fizikisht, gjatë seancave të Kleringut, janë:
 - Urdhër - xhirimet,
 - Ceqet,
 - Letër - Pagesat.
- Në kuptim të kësaj Marrëveshje, instrumentet e mësipërme do të quhen "dokumente".
- Në kuptim të kësaj Marrëveshje, cdo Bankë që e nënshkruan atë, quhet "anëtar" i Kleringut.
- Banka e Shqipërisë, bën hërë pas here përcaktime dhe modifikime në rregullat e kryerjes së kleringut të pagesave nëpërmjet instrumentave të ndryshëm.
- Banka e Shqipërisë, organizon dhe drejton seancat e Kleringut të pagesave.
- Banka e Shqipërisë merr pjesë si anëtare në të gjitha seancat e Kleringut, për veprimet e saj në lidhje me Bankat e nivelit të dytë.

PROCEDURA E VEPRIMIT_

1. Anëtarët, janë të detyruar të paraqesin në seancat e Kleringut, dokumentacionin që vërteton vlerat e transaksioneve që regjistrohen, si dhe cdo informacion tjetër të nevojshëm për funksionimin e rregullt të shlyerjes.
2. Pjesëmarrja në Kleringun ditor të pagesave, i detyron anëtarët të zbatojnë këtë Marrëveshje dhe Rregulloret e tjera që kanë lidhje me të, në raportet me Bankën e Shqipërisë, si organizuese dhe drejtuese e Kleringut, dhe me cdo anëtar tjetër të tij.
3. Mbyllja e Kleringut ditor të pagesave deklarohet nga Banka e Shqipërisë.
4. Në rast se një anëtar, nuk ka saldo kreditore të mjaftueshme për të përballuar pagesat e sjella në favor të anëtarëve të tjerë, seanca e Kleringut pezullohet. Veprimet e sjella nga anëtari që nuk ka gjendje të mjaftueshme, fshihen nga dokumentat e Kleringut edhe të anëtarëve të tjerë, dhe për këta të fundit Kleringu mbyllet.
5. Cdo anëtar, është i detyruar të marrë pjesë në të gjitha seancat, me qëllim që ti lejojë anëtarëve të tjerë të dorëzojnë dokumentet, në lidhje me veprimet për të cilat ai rezulton kreditor. Nëse për shkak të forcave mëdha, të dokumentueshme, anëtari

nuk mund të sigurojë prezencën, ai duhet të lajmërojë Bankën e Shqipërisë përpara zhvillimit të seancës.

6. Orari për zhvillimin e seancave caktohet nga Banka e Shqipërisë.

7. Anëtarët duhet të zbatojnë me përpikmëri orarin e zhvillimit të seancave, me detyrimin për të mos u larguar derisa seanca të deklarohet e mbyllur.

8. Cdo anëtar duhet t'u komunikojë me shkrim të gjithë anëtarëve të tjerë:

- Emrat e personave të autorizuar prej tij, për përfaqësimin në seancat e Kleringut.
- Firmat e autorizuar për të kryer veprime në Klering.
- Rastet e shfuqizimit dhe zëvendësimit të tyre si dhe datën në të cilën ndryshimet e bëra hyjnë në fuqi.

Banka e Shqipërisë nuk mban asnjë përgjegjësi për pasojat që mund ti sjellë secili anëtar, nga moszbatimi në kohë pikës së mësipërme.

9. Dokumentet shkëmbehen nga anëtarët më anë të zarfeve të mbyllura. Metoda e përgatitjes së tyre përcaktohet nga Banka e Shqipërisë në një Manual të posacëm bashkangjitur kësaj Marrëveshje.

10. Cdo anëtar duhet ti kontrollojë menjëherë dokumentet, në ambjentet e saj, për tu siguruar për rregullshmërinë e tyre.

11. Dokumentet, të cilat për çfarëdo motivi anëtarët i gjykojnë si të parregullta, duhet të kthehen në Klering nga ana e tyre, brenda së njëjtës ditë ose në ditën pasardhëse të punës (në rast festash zyrtare), pas prezantimit në Klering. Në cdo rast, ato do të konsiderohen si dokumente të reja.

12. Saldot përfundimtare të Kleringut, konsiderohen të pranuar nga secili anëtar, me kalimin e tyre në llogaritë përkatëse.

TE FUNDIT

Kjo Marrëveshje mund të modifikohet me pëlqimin e shumicës së pjesëmarrësve nënshkrues të kësaj marrëveshje.

- Nga kjo Marrëveshje, si dhe mbështetur në Ligjin nr.8076, datë 22/02/1996 "Për Bankën e Shqipërisë", dhe Ligjin nr. 8075 datë 22/02/1996 "Për sistemin bankar në Republikën e Shqipërisë", pjesëmarrësit nënshkruës të kësaj Marrëveshje i njohin të drejtën Bankës së Shqipërisë për vendosjen e gjobave, deri në masën e 5 (pesë) pagave mujore ndaj administratorëve të Bankave, për cdo shkelje apo pretendim të pa motivuar, që sjell pasoja në zbatimin e kësaj Marrëveshje

- Cdo Bankë e re që krijohet, si Bankë e nivelit të dytë, është subjekt i kësaj Marrëveshje, dhe ftohet të nënshkruajë atë, brenda 30 diteve nga data e fillimit zyrtar të aktivitetit të saj në territorin e Republikës së Shqipëris

MANUAL

-Mbi përgatitjen e dokumentave për tu prezantuar në Klering -

Sipas pikës 9 të Marrëveshjes ndërmjet Bankës së Shqipërisë dhe Bankave të nivelit të dytë "Mbi Zhvillimin e Kleringut", Banka e Shqipërisë harton këtë manual për mënyrën e përgatitjes së dokumenteve për tu prezantuar në klering.

Me marrjen e postës nga degët e tyre, në Drejtoritë e Përgjithshme të Bankave do të bëhet ky grupim

- Sipas seciles bankë përfituese, do te organizohen tre grupe dokumentesh

1. Urdhër - xhirimet me vlera deri 1,000,000 Lekë,
2. Urdhër - xhirimet me vlera më to mëdha se 1.000.000 lëkë
3. Për secilin grup dokumentesh hartohet nga një strishe përkatëse që do të pasqyrojë shumën e përfshirë në seicilin prej tyre.

- Hartohet fleta përcjellese për në Klering e cila duhet të përmbajë këto të dhena

1. Emrin e Bankës
2. Instrumenti i pagesës që po dërgohet në Klering.
3. Emri i Bankës përfituese.
4. Vlera totale e dokumenteve që po dërgohen në klering
5. Numri i dokumenteve të përfshirë në vlerën totale.
6. Nënshkrimi që do te bëhet nga personi i autorizuar për të përfaqësuar Bankën në klering

Fleta përcjellëse do to hartohet në tre kopje.

- Kopja e parë do ti dorëzohet specialistit te Bankës së Shqipërisë për t'iu bashkangjitur Pasqyrës së Kleringut që hartohet prej tij,

- Kopja e dyte do to mbyllet ne zarf për t'iu dhënë Bankës përfituese së bashku me dokumentet.

- Kopja a tretë do to ngjitet në shpinë to zarfit, për te identifikuar zarfet.

Zarfat nuk do to hapen në Zyrën e Kleringut në Bankën a Shqipërisë.

URDHËR - XHIRIMË ME VLERË DERI NË 1,000,000.00 LEKË

NGA	BANKA	(DËRGUESË)
PËR	BANKA	(PËRFITUESË)

NUMRI I URDHËR-XHIRIMËVE
VLËRA Ë URDHËR-XHIRIMËVE

NËNSHKRIMI

URDHËR - XHIRIMË MË VLERË MBI 1,000,000.00 LEKË

NGA	BANKA	(dërguese)
PËR	BANKA	(përfituese)

NUMRI I URDHËR-XHIRIMEVE
VLËRA Ë URDHËR-XHIRIMEVE

NËNSHKRITIMI

ÇEQE

NGA
PËR

BANKA
BANKA

(dërguëse)
(përfituëse)

NUMRI I ÇEQEVE
VLERA E ÇEQEVE

NËNSHKRIMI